



VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI

Data e miratimit: 27 mars 2019

Numri i lëndës: 2018-04

Afrim Islami

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 27 mars 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. Ronald HOOGHMSTRA, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2019,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar me datën 24 shtator 2018.
2. Më 28 qershor 2016 dhe 17 tetor 2017, Paneli ka marrë dy vendime të papranueshmërisë lidhur me ankesat e mëparshme të parashtuara nga i njëjti ankues dhe që në përgjithësi kanë të bëjnë me të njëjtat ngjarje.
3. Më 21 dhjetor 2018, Paneli ka kërkuar nga shefja e Misionit të ofronte një deklaratë gjithëpërfshirëse rreth kompetencave të EULEX-it lidhur me monitorimin e ndjekjeve penale dhe rasteve gjyqësore sipas mandatit të tij aktual.
4. Më 24 janar 2019, ShM-ja ka ofruar përgjigjen e saj.

5. Më 21 shkurt 2019, përgjigjja e ShM-së iu ishte dërguar parashtruesit të ankesës për informatë.
6. Pas dorëheqjes së fundit të një prej anëtarëve të përhershëm, Paneli do të mbledhet rreth kësaj çështje vetëm me dy anëtarë të vet, në përputhje me rregullën 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

II. FAKTET

7. Faktet e lëndës të paraqitura nga ankuesi mund të përmbliidhen si më poshtë:
8. Më 19 korrik 2018, ankuesi ka paraqitur një letër në selinë e EULEX-it duke kërkuar që EULEX të monitorojë çështjen penale ndaj tij, e cila aktualisht është e pazgjidhur pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë.
9. Ankuesi pohon se akuzat ndaj tij janë të motivuara nga interesa politike dhe të ndikuara nga elementë të organizuar kriminalë.
10. Ankuesi nuk ka marrë ndonjë përgjigje nga EULEX-i lidhur me atë kërkesë dhe EULEX-i nuk e ka monitoruar lëndën e tij.

III. ANKESAT

11. Duke mos u thirrur në ndonjë dispozitë të veçantë të instrumenteve ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ankuesi pohon se çështja penale ndaj tij është rezultat i ndikimeve politike dhe kriminale. Nga përmbajtja e ankesës është e qartë se ai pretendon që pa pasur monitorim nga EULEX-i, atij nuk mund t'i ofrohet gjykim i drejtë, siç garantohet me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

IV. LIGJI

12. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç është reflektuar në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
13. Para shqyrtimit të ankesës mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse do të pranojë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
14. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, të rregullores së punës, deri më 14 qershor 2018, Paneli mund të shqyrtojë ankesat në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv. Pas kësaj date, mandati i Misionit ka ndryshuar dhe ai kryen vetëm funksionin e mentorimit në lidhje me procedurat gjyqësore.

15. Paneli thekson se nën mandatin e tij aktual, bazuar në Vendimin e Këshillit CFSP 2018/856 të 8 qershorit 2018, dhe të përshkruar nga ShM-ja në letrën e saj të datës 24 janar 2019 -

"EULEX-i Kosovë bënë monitorimin e rasteve dhe gjykimeve të përzgjedhura në institucionet e Kosovës të drejtësisë penale dhe civile, në bashkërendim të ngushtë me akterët e tjerë të BE-së. Këtu përfshihen, por jo vetëm, rastet që u janë dorëzuar institucioneve përkatëse të Kosovës. Stafi përkatës i Misionit gjendet në të njëjtin vend me institucionet e caktuara të Kosovës. Rastet e përzgjedhura monitorohen prej fazës së hetimeve deri tek ekzekutimi i dënimeve. Gjatë zbatimit të mandatit të monitorimit, EULEX-i Kosovë e respekton në tërësi parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

[...]

"EULEX-i Kosovë kryen monitorim sistematik, tematik dhe ad hoc. EULEX-i Kosovë i ofron vlerësimet dhe gjetjet e tij tek institucionet e Kosovës dhe i informon akterët e tjerë përkatës të BE-së me qëllim të fuqizimit të avancimit të Kosovës në rrugën e saj evropiane".

16. Në rastin në fjalë, Paneli konstaton se nuk është argumentuar, e lëre më parë, se EULEX-i ishte, apo do të jetë, në ndonjë mënyrë, i përfshirë në shkeljet e supozuara të të drejtave të ankuesit.
17. Për më tepër Paneli po ashtu thekson se ankuesi ka kërkuar ndihmën nga Shtylla e Monitorimit të EULEX-it për të monitoruar procedurat penale ndaj tij. Megjithatë, bazuar në mandatin e tij aktual, nuk është treguar se EULEX-i Kosovë do të jetë i detyruar të monitorojë këtë lëndë të veçantë. As nuk është treguar se mos monitorimi nga ana e Misionit i kësaj lënde ka qenë arbitrar apo ka kontribuar në shkeljen e të drejtave të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE,

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo është qartas e pabazë sipas nenit 29 (1) (e) të rregullores së vet të punës, dhe

SHPALL ANKESËN TË PAPERANUESHME.

Për Panelin,

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Anna BEDNAREK
Anëtare